



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“STUDIM DHE ANALIZË MBI KOHERENCËN DHE STANDARDET
E PRITSHME TË SPECIALISTËVE GJUHËSORË
NË FUSHËN E TURIZMIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR”**

FINANCUAR NGA UNIVERSITETI I TIRANËS
NË KUADËR TË PROGRAMIT “UT-KËRKIM, EKSELENCË DHE INOVACION”
2023



Ekipi i projektit:

Dr. Drita RIRA (drejtuese e projektit)

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha

Prof. Dr. Saverina Pasho

Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti

Prof. Asoc. Dr. Alnida Koroshi

Znj. Vasilika Mulla



Organizimi i tavolinës së rrumbullakët me temë:

“Industria e Turizmit në Shqipëri dhe nevojat e saj për profesionistë”



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja



INDUSTRIA E TURIZMIT NË SHQIPËRI DHE NEVOJAT E SAJ PËR PROFESIONISTË



22.11.2023 ⌚ **10:00**



**Fakulteti i Gjuhëve të Huaja,
Godina A, "Salla Rozafa"**

Në datën 22 nëntor 2023 në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës u zhvillua veprimtaria me temë: “Industria e Turizmit në Shqipëri dhe nevojat e saj për profesionistë”.



Në këtë veprimtari të organizuar në formatin e një tavoline të rrumbullakët, morën pjesë sipërmarrës dhe përfaqësues të operatorëve turistikë të rëndësishëm në vend, si:

- Agjencia Ecotour Albania
- Agjencia Zemra Travel
- Agjencia Elite Travel
- Agjencia Ideal Travel and Tours Shpk
- Agjencia My Albania Nature Explorer
- Agjencia Discover Albania
- Agjencia Vas Tour
- Agjencia Outdoor Albania
- Agjencia Selectours Albania
- Agjencia AvenTour Albania
- Agjencia Veal Travel
- Medical Tourism in Albania
- Ekspertë në fushën e turizmit
- Institucioni Parqet Arkeologjike të Apolonisë dhe Bylis
- Shoqëria Cosmos Translations & Events Shpk



Aktiviteti u konceptua dhe drejtua nga Dr. Drita Rira, Zv/Dekane e FGJH njëkohësisht koordinatore e projektit fitues “Studim dhe analizë mbi koherencën dhe standardet e pritshme të specialistëve gjuhësorë në fushën e turizmit në kontekstin shqiptar” i programit UT-Kërkim, Ekselencë, Inovacion.



Ky takim që u bashkëdrejtua nga Dekania e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Prof. Dr. Esmeralda Kromidha pati si qëllim ndërtimin e një dialogu mes aktorëve universitarë (pedagogë e studentë) me tregun e punës në industrinë e turizmit (sipërmarrës të industrisë së turizmit që operojnë në vend e në rajon), rrahjen e problematikave dhe parashtrimin e pyetjeve që lidhen me këtë sektor, përkatësisht:

-A ka profesionistë të mjaftueshëm në Shqipëri për fushën e turizmit duke konsideruar fluksin gjithnjë e në rritje të vizitorëve të huaj? Cilat “zanate-profesione” janë më të nevojshme dhe a ka një standardizim të tyre? Cilat janë nevojat konkrete të këtij sektori për profesionistë të gjuhëve veçanërisht me zhvillimin e inteligjencës artificiale?



Diskutimet u ndalën tek prezantimi i kompanive/sipërmarrësve mbi aktivitetin e tyre dhe nevojat përkatëse për profesionistë të gjuhëve në industrinë e turizmit, ndër të cilët histori sukcesi të Alumni FGJH dhe vijuan me pritshmëritë e bizneseve ndaj profesionistëve të gjuhëve dhe kulturave të huaja, mbi specifikat e formimit dhe trajnimit të tyre, rolin e praktikës profesionale si një mjet motivimi në karrierën profesionale.







Vlerë e shtuar në këtë aktivitet ishte prezantimi i **Draft Platformës Digjitale “Biznes – FGJH”** përparitur nga departamenti i IT-FGJH, të cilët paraqitën idenë inovatore të FGJH-së mbi ngritjen e një platforme ndërvepruese, si një projekt ambicioz që mund të sjellë shumë avantazhe për komunitetin e biznesit në bashkëpunimin dhe ndërveprimin me Fakultetin tonë.





Aktiviteti përmbushi të gjitha objektivat e parashikuara dhe ngjalli interes të veçantë edhe ndaj mediave kombëtare në vend si: TVSH, TOP CHANNEL, MCN TV, të cilat ofruan kontributin e tyre duke i dhënë zë këtij aktiviteti të rëndësishëm me qëllim rritjen e standardeve të shërbimeve turistike që aspirojmë të arrijmë.

Video të këtyre kronikave gjenden në link-et më poshtë:

RTSH: https://youtu.be/NeHHECZLr1U?si=yE_qzX59rp-6G0l-

RTSH: <https://youtu.be/g24UiUBuyqM?si=ewLPFW4wYknhbpFV>

MCN TV: <https://youtu.be/BhBXoV8tlcs?si=m59kPQvjo5PZ2Bwd>

TOP CHANNEL ALBANIA: <https://www.youtube.com/watch?v=3iTi4Ar4CuY>

Publikime të këtij aktiviteti janë pasqyruar edhe në web zyrtar dhe rrjetet sociale të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

link:

<https://www.facebook.com/FAKULTETIiGJUHEVEteHUAJAiUT/posts/pfbid0xafM9YX19ZeW4dFiKxCmGJMF2M9z3oVU6cegWHFjdxejzLk8SQmyZoEYgrjWhvJdl>